



Pejë, më 17 mars 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL
ndërmjet
UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" TË PEJËS
dhe
INSTITUTIT SHQIPTAR TË SOCIOLOGJISË

Universiteti "Haxhi Zeka" i Pejës dhe Instituti Shqiptar i Sociologjisë – Shoqata Sociologjike Shqiptare (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut e Diasporë) në vijim "palët", të vetëdijshëm për përfitimet e ndërsjellta të bashkëpunimit institucional, bien dakord dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, e cila parashikon:

- Mbështetjen e ndërsjelltë për realizimin e misionëve të secilit institucion, për të nxitur zhvillimin e shkencave sociale dhe humane, për shkëmbimin e përvojave, botimeve akademike, teksteve etj., të realizuara nga anëtarë të stafit akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të tyre;

- Vënien në dispozicion të literaturës shkencore të çdonjërit nga institucionet për stafin akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të institucionit partner;

- Krijimin e një rrjeti të gjerë komunikimi, duke përfshirë anëtarët e stafit akademik dhe bashkëpunëtorët shkencorë të këtyre institucioneve, si dhe pasqyrimi i veprimtarive të përbashkëta në website-t, mediat e tyre apo në forma të tjera të mundshme;

- Organizimin e përbashkët të konferencave shkencore, simpoziumeve, forumeve akademike, seminareve, leksioneve të hapura, trajnimeve etj.

Palët angazhohen për organizimin e përbashkët, si dhe me institucione të tjera partnere, të serisë së konferencave vjetore duke filluar nga konferenca e 19-të vjetore me temë kuadër "Mirëqenia në kohë sfiduese" [Well-being in Challenging Times] që do të mbahet në Prishtinë, në nëntor 2024.

Në veçanti, palët angazhohen për organizimin, në Universitetin "Haxhi Zeka" të Pejës, të njëres nga konferencat vjetore ndërkombëtare. Për tematikën,

detyrimet e ndërsjellëta si dhe për modalitetet e tjera të organizimit të kësaj konference vendoset bashkërisht, jo më vonë se një vit para zhvillimit të saj.

Kjo marrëveshje është e vlefshme për 5 (pesë) vjet. Ajo mund të zgjidhet para këtij afati me kërkesën e njëres palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën gjashtë muaj më parë. Njëherësh kjo marrëveshje mund të zgjatet automatikisht për një afat të pacaktuar nëse nuk ka kërkesë me shkrim për zgjidhjen e saj nga ndonjëra prej palëve nënshkruese të saj.

Për realizimin e kësaj marrëveshje caktohet një komision i përbashkët, për përbërjen e të cilit vendosin nënshkruesit e kësaj marrëveshje.

Kjo marrëveshje hartohet në 3 (tre kopje), nënshkruhet nga titullarët e institucioneve respektive dhe merr fuqi zbatuese për institucionet përkatëse nga data e nënshkrimit të saj.

Rektor i Universitetit "Haxhi Zeka" të
Pejës
Prof. Dr. Armand KRASNIQI



Drejtor i Përgjithshëm i Institutit
Shqiptar të Sociologjisë
Prof. Dr. Leke SOKOLI



		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	1141	Nr. i faq / Br. str / No. pg	2
Data / Datum / Data		07.05.2024	
		Pejë / Poë	